

# SI MUND TË PARANDALOHET

## Ekstremizmi i Dhunshëm!


### *Kujdesi dhe paqja fillojnë në shtëpi!*

- *Ndani informacion*
- Bisedoni me fëmijët dhe të rinjtë për *aktivitetin e tyre në internet*
- Njihni më nga afër *miqtë e fëmijëve dhe të afërmeve tuaj*
- Realizoni *aktiviteteve të përbashkëta*, pasi është shumë e rëndësishme që të kaloni kohë cilësore me fëmijët dhe të rinjtë
- Diskutoni mbi *paqen, tolerancën dhe zgjidhjen e shëndetshme të konflikteve*. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që ju të jeni vetë një model i tillë për fëmijët dhe të rinjtë.

Ky material është realizuar si pjesë e projektit “Fuqizimi i grave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në shoqëri”, të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



# PAQJA

## *fillon në shtëpi!*

Ekstremizmi i dhunshëm lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e cila justifikohet për shkak të disa pikëpamjeve politike shumë të ashpra (radikale), ideologjike dhe/ose fetare.



EKSTREMIZMI I DHUNSHËM shkon përtej dhunës në familje! Ekstremizmi i dhunshëm NUK lidhet vetëm me çështjet e besimit fetar!

## • Vajzat dhe gratë, promovuese të paqes!

**YWCA of Albania** kërkon të sfidojë mitin se vajzat dhe gratë janë thjesht viktima ose të mbijetuara të ekstremizmit të dhunshëm. Përkundrazi, vajzat dhe gratë janë:



- faktorë kyç në nxitjen e ndryshimeve pozitive në shoqëri
- përçuese të vlerave të humanizmit
- komunikuese të denja të paqes
- një zë i fortë kundër padrejtësive dhe dhunës
- lidere të suksesshme dhe gjithëpërshirëse

Për këtë arsye, është e nevojshme fuqizimi dhe mbështetja e vazhdueshme e grave dhe vajzave, me qëllim rritjen e përfshirjes së tyre në shoqëri, në vendimmarrje dhe në dhënien e kontributit për çështje sensitive!

## • Të rinjtë dhe grupet ekstremiste

Të rinjtë, fëmijët dhe adoleshentët janë më të rrezikuar për mbështetjen dhe përfshirjen në grupet ekstremiste. Çdo fëmijë apo i ri mund të jetë i ndikuar nga grupet ekstremiste, edhe pse disa prej tyre mund të jenë më të rrezikuar për shkak të faktorëve, të tillë si:

- Gjendja e vështirë ekonomike
- Situata politiko-kulturore
- Papunësia
- Mospërputhja midis nivelit arsimor dhe statusit të punësimit
- Të qëndruarit online për një kohë të gjatë
- Përjashtimi social/Diskriminimi

## Shenjat paraprake

që mund të jenë tregues të përfshirjes në grupe ekstremiste:



- ❖ **Ndryshime të humorit**
- ❖ Largim nga **familja apo miqtë**
- ❖ Ndryshime në **pamje ose në veshje**
- ❖ **Humbje e interesit** për të marrë pjesë në aktivitete sociale
- ❖ Krijimi i **miqësive** të dyshimta
- ❖ Ndryshime të lidhura me **gjendjen financiare**
- ❖ Të folurit në mënyrë të ndarë **'ata dhe ne'**
- ❖ Shprehja dhe mbështetja e **ideve ekstremiste**
- ❖ Vendosja e kontakteve me persona të **organizatave ekstremiste**
- ❖ **Përpjekje për të përfshirë** dhe për të bindur të tjerët për t'u angazhuar në grupe ekstremiste
- ❖ **Të qenët i/e fshehtë dhe ngurrues/e** për të diskutuar aktivitetet, vendndodhjen, bashkëpunëtorët
- ❖ Kalimi i kohës së tepërt **në internet ose në telefon**
- ❖ Të pasurit e **disa identiteteve online**
- ❖ Zotërimi i **disa telefonave** celularë ose pajisjeve të tjera
- ❖ Mbatja në mënyrë **shumë të fshehtë dhe strikte** e pajisjeve telefonike